



Pranuar / Dorezuar Priniljen/Prodato Received/Delivery	31.07.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Pislog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SHKRETI	5464/2023		115



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.862/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi-Prenaj Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.862/2023 të datës 16.06.2023, të parashtruar nga ankuesi me adresë: Rr "Lidhja e Prizrenit", Komuna e Ferizajt, kundër organit të punësimit Administrata Tatimore e Kosovës, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës" duke vepruar në duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 28.07.2023, mori këtë:

### V E N D I M

- I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër Nr.12.06-2276 i datës 07.06.2023, i Divizionit të Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës.
- II. OBLIGOHET Divizioni i Standardeve Profesionale i Administratës Tatimore të Kosovës që në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij Vendimi, të ndërmarret të gjitha veprimet procedurale ligjore për ta rishqyrtuar lëndën e ankuesit
- III. OBLIGOHET Drejtori i Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës, që të ndërmarret të gjitha veprimet për zbatimin e këtij Vendimi brenda afatit të përcaktuar nën pikën II të këtij Vendimi.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.



## A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar sipas Akt Emërimit me numër AE.Nr.469/2022 të datës 31.12.2022 në pozitën e punës “Inspektor i mesëm tatimor” në Administratën Tatimore të Kosovës. Më datë 05.06.2023 ka parashtruar kërkesë me numër të protokollit Nr. ZQ/12-06/2261 në Drejtorin e Standardeve Profesionale me të cilën kërkon leje për punë sekondare jashtë Administratës Tatimore të Kosovës.

Më datë 07.06.2023 Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerrë Vendimin me numër Nr.12-06-2276 me të cilin e ka refuzuar kërkesën me numër të protokollit Nr. ZQ/12-06/2261 të parashtruar nga ankuesit, për angazhim në punë sekondare në pozitën e “kameramanit, fotografit dhe ndihmësit në punët tjera” te subjekti “Binakët Pro-SHPK”.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër Nr.12-06-2276 të datës 07.06.2023 të Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 16.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 4817/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor se i lejohet puna sekondare jashtë orarit zyrtar si inspektor i mesëm tatimor.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.06.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë te Administrata Tatimore e Kosovës. Ndërsa Këshilli me datë 30.06.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë me numër Nr.643 nga Administrata Tatimore e Kosovës me të gjitha shkresat e lëndës.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave ka Administruar këto Prova:** Ankesa me numër protokollit 4817/2023 e parashtruar nga ankuesi më datë 16.06.2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesë për punë sekondare-jashtë ATK-së me numër Nr.12.06.2261 e datës 05.06.2023; Vendimin me numër Nr.12-06-2276 të datës 07.06.2023; Certifikatë e regjistrimit të biznesit me numër 812020311 e datës 03.03.2023; Aplikacion 25010209773 i datës 27.02.2023; Dokument identifikues për P.G; Autorizim; Dokument identifikimi për H.G; E-mail i datës 02.06.2023; Vendim për ndryshim statusi i datës 22.05.2023; Statuti i biznesit SH.P.K i datës 22.05.2023; E-mail 19.05.2023; E-mail i datës 12.05.2023; E-mail i datës 09.06.2023; E-mail i datës 07.06.2023; Akt Emërimit me numër Nr.02/1172/11 i datës 28.08.2019; Akt Emërimit me numër Nr.02/1172/11 i datës 16.09.2020; Akt Emërimit me numër AE.Nr.469/2022 i datës 31.12.2022; Vendim me numër 2425/01 i datës 22.12.2022; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 22.06.2023; Përgjigje në ankesë e datës 30.06.2023; Kodi i Etikës së Komunikimit në Administratën Tatimore të Kosovës me numër protokollit 09-06-1105 i datës 16.03.2023; Rregullore e Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës; Formulari i deklaratës mbi gjendjen e konfliktit të interesit; E-mail i datës 15.05.2023; E-mail i datës 17.05.2023.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, në bazë të dispozitës së nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ekziston baza ligjore që lënda *duhet të kthehet në rishqyrtim në Divizionin e Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës.*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht Aktit të Emërimit të ankuesit me numër AE. Nr. 469/2022 të datës 31.12.2022, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se i njëjti është i punësuar në pozitën e punës *"Inspektor i mesëm tatimor"* në Administratën Tatimore të Kosovës, ndërsa më datën 05.06.2023 ka parashtruar kërkesë me numër protokoll Nr.prot.12.06-2261 në Divizionin e Standardeve Profesionale të Administratës Tatimore të Kosovës përmes së cilës kërkon që ti lejohet puna sekondare si *"kameraman, fotograf dhe ndihmës në punët tjera"* aktivitet jashtë ATK-së për periudhën kohore nga data 01.07.2023 me afat të pa caktuar kohorë në Biznesin *"Binakët Pro"* SH.P.K me numër të regjistrimit 812020311.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës pas pranimit të kërkesës me numër të protokollit me numër protokoll Nr.prot.12.06-2261 të datës 05.06.2023 të parashtruar nga ankuesi ka shqyrtuar rastin dhe me datë 07.06.2023 nxjerr Vendim me numër me numër Nr.12.06-2276 me të cilin vendim ankuesit i refuzon kërkesën për pune sekondare jashtë aktivitetit të ATK-së, me arsyetimin se pozita në cilësinë e kameramanit, fotografit dhe ndihmësit në punët tjera nuk lejohet sipas nenit 6 të Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës, gjithashtu biznesi *"Binakët Pro"* SH.P.K me numër regjistrimi 812020311 në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës rezulton se ka një përshkrim të aktiviteve (*kontabilitet, libër mbajtës dhe auditim, këshillime tatimore*) si dhe me këtë numër biznesi figuron edhe emri i biznesit *"Binakët Colsulting"* SH.P.K.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ndërlidhur me arsyetimin e vendimmarrjes nga ana e Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e nenit 6 të Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës ku përcaktohet se : **1. "Zyrtari i ATK mund të angazhohet në punë sekondare në lëmit si: shkencë, sport, mësimdhënie, trajnime, seminare, hulumtime borde (Ndërmarrje Publike, Ndërmarrje Shoqërore dhe Organizata Buxhetore) kulturë dhe veprimtari humanitare. Këto aktivitete mund të ushtrohen nga zyrtari i ATK, nëse nuk ka konflikt të interesit apo nëse aktiviteti nuk është i ndaluar me dispozitat tjera ligjore"**, si dhe nenin 7 paragrafin 6 nën paragrafin 6.2 dhe 6.3 të njëjtës Rregullore ku përcaktohet se: **6.Zyra e Standardeve Profesionale refuzon kërkesën për angazhim në punë sekondare, në rastet kur: "6.2. Angazhimi në punë sekondare bie ndesh me legjislacionin për konfliktin e interesit; 6.3. Angazhimi në punë sekondare pengon aktivitetin në ATK"**, si dhe Ligjin Nr.06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike nenin 11 ku përcaktohet qartë se: **1. Zyrtarit i ndalohet që të kryejë punë të tjera nëse: "1.1. mund të keqpërdorë informacionin zyrtar për interesa private; 1.2. punët e tilla mund të ndikojnë në paanshmërinë e ushtrimit të detyrës publike dhe cenojnë respektimin e parimeve të**



*konkurrencës së lirë; 1.3. angazhime të tilla mund të dëmtojnë reputacionin e institucionit; 1.4. angazhimi ka të bëjë me zgjedhjen, emërimin apo caktimin në institucione vartëse të institucionit punëdhënës, me përjashtim kur një angazhim i tillë është paraparë me ligj të veçantë”, dhe ka ardhur në përfundimin se Divizioni i Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës nuk ka arritur të jetë bindës në arsyetimin e bërë në Vendimin me numër Nr. 12.06/2276 të datës 07.06.2023 përmes të cilit ankuesit i ka refuzuar kërkesën për lejimin e punës sekondare dhe ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e lartcekura ngase në arsyetimin e Vendimit nuk ka arritur të përshkruaj se cilat veprime apo aktivitete të ankuesit gjatë angazhimit në punë sekondare do te pengonin aktivitetin e të njëjtit në ATK.*

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, po ashtu ka konstatuar që me dispozitat e nenit 7 dhe 11 të Rregullores së Brendshme për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Administratën Tatimore të Kosovës janë përcaktuar kompetencat e Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, si në vijim: 7 Zyra e Standardeve Profesionale, brenda shtatë (7) nga data e pranimit të kërkesës për punë sekondare, shqyrton dhe vendos për kërkesën e aplikuesit si dhe neni 11 paragrafi 2 „ Zyra e Standardeve Profesionale , bazuar në legjislacionin ne fuqi si dhe rregullore te brendshme, trajton rastin ne lidhje me konfliktin e interesit..... dhe paragrafi 5. Zyra e Standardeve Profesionale mund te kërkoj edhe nga AKK te trajton rastin”. Në pajtim me këto dispozita ligjore, Divizionit të Standardeve Profesionale ka mandat të shqyrtojë dhe të kërkoj dëshmi nga cili do person i cili mund të jetë në dijeni lidhur me çfarë do çështje që i nënshtrohet konfliktit të interesit dhe që në bazë të provave të prezantuara të vendos lidhur me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit, po ashtu duke u bazuar në dispozitat e lartë cekura Kolegji konstaton se edhe për kundër faktit se Divizioni për Standarde Profesionale ka mundur të kërkoj nga Agjencia Kundër Korrupsionit të trajtoj rastin i njëjti nuk e ka bërë një gjë të tillë andaj Kolegji i Këshillit konstaton se organi i punësimit në këtë rast Administrata Tatimore e Kosovës -Divizioni i Standardeve Profesionale me rastin e rishqyrtimit të rastit të ankuesit lidhur me lejimin e punës sekondare jashtë aktivitetit të ATK-së, gjegjësisht lidhur me ekzistimin e mundshëm të konfliktit të interesit është i obliguar që të merr opinion ligjor nga organi kompetent respektivisht Agjencia Kundër Korrupsionit.

Po ashtu Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Vendimi me numër Nr.12-06-2276 të datës 07.06.2023 të Divizionit të Standardeve Profesionale në Administratën Tatimore të Kosovës, është nxjerr në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative, gjegjësisht me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1, 1.2, 1.3 dhe 1.4 dhe me nenin 48 paragrafi 2 që rregullojnë formën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ, sepse rrjedhimisht vendimi nuk arsyeton gjendjen faktike dhe bazën juridike siç përcaktohet të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse vendimi i lartë cekur përmban vetëm formulime të përgjithshme por mungon arsyetimi me i detajuar se me cilat veprime apo aktivitete të ankuesit gjatë angazhimit në punë sekondare do te pengonin aktivitetin e ankuesit në ATK.



Duke marr parasysh faktet e lartë cekura, Kolegji për shqyrtimin e ankesave nuk është lëshuar në shqyrtimin e fakteve tjera apo shkeljeve tjera eventuale në këtë procedurë.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrtës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër Vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr.862/2023*

Kaltrina Avdullahi-Prenaj

*[Signature]*  
Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI  
*[Signature]*  
Kryetare e Kolegjit



**Vendimi i dorëzohet:**

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Administratën Tatimore të Kosovës
- Njësisë së Burimeve Njerëzore në Administratën Tatimore të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.